



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

U D H Ë Z I M

Nr. 16/1, datë 17.10.2018

PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.16, DATË 8.5.2018 "PËR ZHVILLIMIN E VETËVLERËSIMIT NË INSTITUCIONET OFRUESE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL"**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 24, pika 1 ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", neneve 26, 54 dhe 60 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJ:

Në pikën 1 të kreut 7 "Dispozita të fundit", të Udhëzimit Nr. 16, datë 08.05.2018 "Për zhvillimin e vetëvlërësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional", shtohet pika 1.1. si më poshtë:

Ngarkohen institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional që vetëm në periudhën Tetor 2018 – Maj 2019, të kryejnë procesin e vetëvlërësimit për 5 (pesë) fushat e vetëvlërësimit për vitin paraardhës akademik (2017-2018), ndërsa drejtoritë rajonale të formimit profesional publik do të vlerësojnë vitin kalendarik 2017. Procesi i vetëvlërësimit në këtë rast do të zhvillohet sipas planit të punës në shtojcën 3 të këtij Udhëzimi.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

Arben Ahmetaj



Shtojcë 3

Plani i zbatimit të vetëvlerësimit të institucioneve publike ofruese të AFP-së sipas pikës 1.1 të kreuat 7 “Dispozita të fundit”

	Masat	Afati	Personi përgjegjës
1	Krijimi i ekipit qendror të vetëvlerësimit	12 tetor 2018	Drejtori i IoAFP-së
2	Miratimi i ekipit të vetëvlerësimit nga këshilli i mësuesve	19 tetor 2018	Këshilli i mësuesve
3	Hartimi i planit të vetëvlerësimit për 5 fushat	26 tetor 2018	Ekipi i vetëvlerësimit
4	Miratimi i planit të vetëvlerësimit nga drejtori	30 tetor 2018	Drejtori i IoAFP-së
5	Zbatimi i vetëvlerësimit (plotësimi i pyetësorëve, vëzhgime, mbledhje informacioni etj.) për tri fusha të përzgjedhura nga institucioni	22 dhjetor 2018	Ekipi i vetëvlerësimit / drejtori/ bordi / mësuesit/nxënësit / bizneset
6	Përpunimi i të dhënave dhe përpilimi i raportit të vetëvlerësimit për tri fushat e përzgjedhura nga institucioni	31 janar 2019	Ekipi i vetëvlerësimit
7	Zbatimi i vetëvlerësimit (plotësimi i pyetësorëve, vëzhgime, mbledhje informacioni etj.) për dy fushat e tjera të cilësisë	31 mars 2019	Ekipi i vetëvlerësimit / drejtori / bordi / mësuesit / nxënësit / bizneset / komuniteti
8	Përpunimi i të dhënave dhe përpilimi i raportit për dy fushat e tjera	10 prill 2019	Ekipi i vetëvlerësimit
9	Përgatitja e raportit të vetëvlerësimit për 5 fushat	30 prill 2019	Ekipi i vetëvlerësimit
10	Miratimi i raportit të vetëvlerësimit nga bordi / këshilli i mësuesve	6 maj 2019	Bordi / këshilli i mësuesve / drejtori i IoAFP-së
11	Publikimi i raportit të vetëvlerësimit / derigimi i raportit të vetëvlerësimit në AKAFPK	10 maj 2019	Drejtori i IoAFP-së